



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës

01 Nr. *M/01-3616* 19
Kaçanik, 07.02.2019

Në mbështetje të dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 – Për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.104/ 02- 34370/18, të datës 30.10.2018- Për formimin e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, publikohet ky:

KONKURS

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1. Me këtë Konkurs, bëhet zgjedhja e **7 (Shtatë)** anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut.
2. Përbërja e anëtarëve të Komitetit Konsultativ si në pikën 1 të Konkursit, duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Kandidatët duhet të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut.

Kriteret për konkurrim:

1. Shkollimi Universitar (Fakulteti);
2. Të jenë njohës të mirë të problematikave dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara.;
3. Preferohet të kenë përvojë pune në fushën e personave me aftësi të kufizuara; dhe
4. Të kenë aftësi komunikuese dhe bashkëpunuese si dhe të jenë të përshtatshëm për punë ekipore.

Mandati i anëtarëve :

Mandati i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është 4 (katër) vjeçar, nga themelimi i Komitetit për persona me aftësi të kufizuara, me mundësi vazhdimi vetëm edhe për një mandat.

Kompetenca e Komitetit :

1. Komitetet Konsultative mund të dorëzojnë propozime nga fushë veprimtaritë e ndryshme në pajtim me Statutin e Komunës, përfshirë :

- dhënien e propozimeve për rregullore të ndryshme;
- hulumtime të ndryshme;
- japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës;
- paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës;
- japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

2. Propozimet e cekura duhet të merren parasysh nga Kuvendi i Komunës për zhvillimin e politikave lokale.

Kompensimi :

- Anëtarët e komiteteve konsultative për punën e tyre kompensohen nga Buxheti i Komunës.
- Shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme të kuvendit.
- Anëtarët e komitetit konsultativ, nuk mund të paguhen për më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje të cilat mbahen brenda një viti.

Dokumentet e nevojshme për Aplikim:

Kopja e Diplomës (e vërtetuar);
Kopja e Letërnjoftimit;
Ekstrakti i Lindjes;
Dëshmia e përvojës së punës (e dëshirueshme) .

Afati i Konkursit :

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga Dita e Publikimit të tij.
Formularët për aplikim merren dhe dorëzohen në Zyrën për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve, kati I-r (Parë) në objektin e komunës.
Dokumentacioni i kompletuar për aplikim dorëzohet në Zarfa të mbyllur në afatin e përcaktuar ligjor, ndërsa dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili dorëzohet jashtë afatit të përcaktuar, nuk do të merret në shqyrtim.
Në intervistë, kandidatet duhet të marrin me veti, Diplomën në origjinal.

